



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 112, datë 27.10.2022

PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE NË
VARËSI TË BASHKISË DURRËS

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.1, shkronjës “b”, të nenit 54 shkronjës “ç”, të nenin 55 pikës 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, të nenit 5, shkronja “d” të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 17 të Vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të titullarëve të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 604, datë 14.09.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi për Menaxhimin Strategjik, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1 shtator 2022 dhe për vitin 2022 do të përballohen nga fondet e lira në buxhetin e miratuar të këtyre institucioneve.
3. Pika 3 e Vendimit nr. 158, datë 23.12.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022 dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024”, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Qendra Kulturore “Aleksandër Moisiu”, Biblioteka e Qytetit, Klubi i Shumësporteve “Teuta”, Klubi i Futbollit “Teuta”, Qendrat Sociale, Qendra Ekonomike e Arsimit, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Ndërmarrja Komunale Plazh, Ndërmarrja e Rrugëve.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022

Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Kulturore "A.Moisiu"

A. PUNONJËSIT ME PAGË GRUPI + SHITESË POZICIONI

A.1	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	paga e grupit	shtesa për vjetërsi	shtesa për pozicion
	1	2	3	4
1	Drejtor	1	2%	65,000
2	Përgjegjës sektori	1	2%	58,000
3	Përgjegjës muzeu	1, 2	2%	54,000
4	Përgjegjës skene	1, 2, 3	2%	54,000
5	Specialist	1, 2, 3	2%	50,000
6	Kurator	1, 2, 3	2%	50,000
7	Skenograf, kostumograf	1, 2, 3	2%	48,000
8	Regjisor	1, 2, 3	2%	52,000
9	Aktor	1, 2, 3	2%	52,000

A. II Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë.

Grupi i diplomës	Lloji diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave, Master i arteve	14,000
	Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	
2	Master profesional	11,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	
3	Bachelor	10,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	

A. III Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

B. PUNONJËSIT E SISTEMIT ME KLASA

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	klasa	shtesa për vjetërsi	paga bazë mujore

	1	2	3	4
1	Cicerone, mjeshtër rekuizitiere, magazinierë mjeshtër skenë, mjeshtër garderobierë, teknik ndricimi, teknik fonie	VIII	1%	38,800
2	Arkivist	VI	1%	37,500
3	Biletashitës, roje, punonjës pastrimi	I	1%	34,000

B. II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja Nr.2

Niveli i pagave për punonjësit e bibliotekës së qytetit

A. PUNONJËSIT ME PAGË GRUPI + SHITESË POZICIONI

A.1	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	paga e grupit	shtesa për vjetërsi	shtesa për pozicion
	1	2	3	4
1	Drejtor	1	2%	60,000
2	Financier	1	2%	54,000
3	Specialist biblioteke	1, 2, 3	2%	50,000

A. II Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë.

Grupi i diplomës	Lloji diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave, Master i arteve	14,000
	Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.	
2	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11,000
	Master profesional	
3	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	10,000
	Bachelor	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	

A. III Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit të çdo punonjësi .

B. PUNONJËSIT E SISTEMIT ME KLASA

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	klasa	shtesa për vjetërsi	paga bazë mujore
	1	2	3	4
1	Libralidhëse	IV	1%	36,500
2	Roje, punonjëse pastrimi	I	1%	34,000

B. II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja nr.3

Niveli pagave për punonjësit e Klubi Shumesporteve "Teuta"

A. PUNONJËSIT ME PAGË GRUPI + SHITESË POZICIONI

A.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	paga e grupit	shtesa për vjetërsi	shtesa për pozicion
	1	2	3	4
1	Drejtore Klubi	1	2%	62,000
2	Përgjegjës zyre	1	2%	58,000
3	Specialist, inspektor	1, 2, 3	2%	50,000
4	Mjek	1, 2, 3	2%	50,000

A. II Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë.

Grupi i diplomës	Lloji diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave, Master i arteve	14,000
	Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.	
2	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11,000
	Master profesional	
3	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	10,000
	Bachelor	

- A. III Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

B. PUNONJËSIT E SISTEMIT ME KLASA

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	klasa	shtesa për vjetërsi	paga bazë mujore
	1	2	3	4
1	Pergjegjes Pishine	X	1%	40,200
2	Shofer transporti me automjet mbi 2,5 ton	VIII	1%	38,800
3	Magaziniere	VI	1%	37,500
4	Punonjes mirembajtes te profesioneve te ndryshme (elektracist, mekanik, marangoz, hidraulik etj)	IV	1%	36,500
5	Puntor sherbimi terrenesh	III	1%	35,800
6	Roje, pastrues	I	1%	34,000

- B.II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja nr.4

Niveli pagave për punonjësit e Klubi Futbollit "Teuta"

A. PUNONJËSIT ME PAGË GRUPI + SHITESË POZICIONI

A.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	paga e grupit	shtesa për vjetërsi	shtesa për pozicion
	1	2	3	4
1	Drejtore Klubi	1	2%	62,000
2	Financiere	1	2%	54,000

A. II Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë.

Grupi i diplomës	Lloji diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave, Master i arteve	14,000
	Master profesional të përfutuar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	

2	Master profesional	11,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	
3	Bachelor	10,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	

A. III Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

B. PUNONJËSIT E SISTEMIT ME KLASA

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	klasa	shtesa për vjetërsi	paga bazë mujore
	1	2	3	4
1	Puntor shërbimi terrenesh	III	1%	35,800
2	Roje, pastrues	I	1%	34,000

B.II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë të çdo punonjësi.

Lidhja nr.5

Niveli pagave për punonjësit e Qendrave sociale dhe Çerdhet (QEA), QKF

A. PUNONJËSIT ME PAGË GRUPI + SHITESË POZICIONI

A.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	paga e grupit	shtesa për vjetërsi	shtesa për pozicion
	1	2	3	4
1	Përgjegjës i Qendrës	1	2%	59,000
2	Financier	1	2%	54,000
3	Punonjës social	1, 2, 3	2%	50,000
4	Kordinator, specialist zyre	1, 2, 3	2%	50,000
5	Përgjegjëse cerdhe	1, 2, 3	2%	50,000
6	Psikolog, mjek, terapist, fizioterapist, logopedist	1, 2, 3	2%	50,000

A.II Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë.

Grupi i diplomës	Lloji diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave, Master i arteve	14,000

	Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	
2	Master profesional	11,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	
3	Bachelor	10,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	

A. III Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

B. PUNONJËSIT E SISTEMIT ME KLASA

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	klasa	shtesa për vjetërsi	paga bazë mujore
	1	2	3	4
1	Kujdestare në cerdhe	VII	1%	38,100
2	Infermiere, guzhiniere, magazinierë, fonist	VI	1%	37,500
3	Ndihmës guzhiniere	III	1%	35,800
4	Shofer	IV	1%	36,500
5	Punonjës mirëmbajtje të profesioneve të ndryshme	IV	1%	36,500
6	Sanitar/pastrues/rrobalarëse, roje	I	1%	34,000

B. II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja nr.6

Niveli pagave për punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale, Ndërmarrjes Komunale Plazh, Ndërmarrjes së Rrugëve

A. PUNONJËSIT ME PAGË GRUPI + SHITESË POZICIONI

A.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	paga e grupit	shtesa për vjetërsi	shtesa për pozicion
	1	2	3	4
1	Drejtor	1	2%	70,000

2	Zv.Drejtor	1	2%	65,000
3	Përgjegjës, kryetar dege	1	2%	60,000
4	Përgjegjës të sektorëve operacional	1,2,3	2%	54,000
5	Specialist, inspektor	1,2,3	2%	52,000

A.II Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit të lartë.

Grupi i diplomës	Lloji diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave, Master i arteve	14,000
	Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	
2	Master profesional	11,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	
3	Bachelor	10,000
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë .	

A. III Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

B. PUNONJËSIT E SISTEMIT ME KLASA

B.I	PAGA MUJORE (LEKË)			
	Emërtesat e pozicioneve të punës	klasa	shtesa për vjetërsi	paga bazë mujore
	1	2	3	4
1	Sekretare	X	1%	40,200
2	Magaznier	IX	1%	39,500
3	Manovrator i makinerive të rënda, manovrator në IMTV	XIII	1%	42,000
4	Shoferi agregati, fadrome , boti, automjet transporti mbi 2,5 ton	XII	1%	41,000
5	Shoferi automjeti transporti mbi 2,5 ton dhe mjeteve speciale	IX	1%	39,500
6	Teknik hidrovori	VI	1%	37,500
7	Puntor të mirëmbajtjes së rrugëve /asfaltues	VI	1%	37,500
8	Shoferi automjeti transporti deri në 2.5 ton	IV	1%	36,500
9	Punonjës mirëmbajtje të profesioneve të ndryshme (mekanik, marangoz, elektrikist, hidraulik etj.)	IV	1%	36,500

10	Puntorët e hidrovorit	IV	1%	36,500
11	Puntor transporti (ngarkim-shkarkimi)	IV	1%	36,500
12	Puntor shërbimi (dezinfektim, gjelberim, krasitje , dekor)	III	1%	35,800
13	Roje uji	II	1%	35,000
14	Roje, fshesar / sanitar /pastrues , gerryes	I	1%	34,000

B.II Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 1 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë .

C. Për puntorët sezonal me kontratë me afat të përcaktuar paga bruto mujore është 34.000 lekë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834/prot.
3



Durrës, më 03/11 .2022


Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË

DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.112 datë 27.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

